



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 23/09 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 23/09 2021

VENDIM
Nr.34, date 23/09/2021

PËR

**KRYERJEN E PROVAVE PER ZBATIMIN E PLANIT TE GADISHMERISE NE RAST
TE EMERGJENCAVE CIVILE TE
SHKAKTUARA NGA SHFRYTEZIMI I DIGAVE TE KASKADES SE LUMIT DEVOLL**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave", si dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM), në mbledhjen e datës 23.09.2021 diskutoi për kryerjen e provave për zbatimin e Planit të Gadishmerisë në rastet e emergjencave civile (PGEC) për rastet e prurjeve të mëdha të shkaktuara nga shfrytëzimi i digave të kaskades së lumit Devoll.

Bazuar në propozimin e Kryetarit të Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM) dhe përfaqësuesit të Agjencisë së Mbrojtjes civile, KKDM,

VENDOSI:

1- Ti kërkoj Kompanisë Devolli Hidropower si shfrytëzues i digave dhe nënobjekteve të tyre:

- Kryerjen e Provave për zbatimin e këtij Plani dhe funksionimin e sistemit të alarmit për digat e kaskades së lumit Devoll brenda muajit Nendor 2021. Këto Prova duhet të kryhen në bashkëpunim me Agjencinë e Mbrojtjes Civile pranë Ministrisë së Mbrojtjes, pushtetin lokal dhe përfaqësuesit e Prefekturës së zonës ku ndodhet Diga. Përpara fillimit të këtyre provave, duhet të hartohet plani i punës dhe organizimit të aktivitetit në fjalë.
- Të informoj KKDM, brenda muajit Dhjetor 2021, për rezultatet dhe problematikat që mund të vërehen gjatë kryerjes së këtyre provave.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për zbatimin e këtij Vendimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

